



VENDIM

Nr. 37, Datë 06.03.2017

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SH.P.K.,
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 5, gërma “e”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë Shoqërinë “Balkan Energy Trade” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI